



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.08.2020, të parashtruar nga Grupi i Operatorve Ekonomik “Ndertimi” sh.p.k. & “Shkemi Gllarevë”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë”, Nr. i prokurimit- 632-20-1596-5-2-1, nxjerr:

### V E N D I M

- I. **1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim nga Grupi i Operatorve Ekonomik “Ndertimi” sh.p.k. & “Shkemi Gllarevë”, e dt.10.08.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë “, Nr. i prokurimit- 632-20-1596-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-20-022-521, kundër **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 03.08.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** e publikuar me datë: 03.08.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

## Arsyetim

Meqë Grupi i Operatorve Ekonomik “Ndertimi” sh.p.k. & “Shkambi Gllarevë”, ka **parashtruar** kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë “, Nr. i prokurimit- 632-20-1596-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-20-022-521,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.08.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Në Njoftimin për kontratë, të dt.23.04.2020, është kërkuar të prezantohen dy cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 10 ton.

Gjatë procesit të Ri-vlerësimit, është vërejtur se ju keni prezantuar vetëm një cilindër, cilindri tjetër nuk figuron në listen e mjeteve dhe për të nuk është prezantuar dëshmi, përveq kësaj lista e paisjeve e ngarkuar nga ju në sistem, është lista e mjeteve e përpiluar për një projekt tjetër-Çabrat -Jahoc (këto nuk janë vërejtur nga Komisioni paraprak).

Pretendimi juaj i I-rë se: Grupit të Operatorëve Ekonomik “Marisa” sh.p.k. & “Company Murseli” sh.p.k., ju mungon diploma e gjeodetit, nuk qëndron, sepse Grupi i Operatorëve Ekonomik “Marisa” sh.p.k. & “Company Murseli” sh.p.k, ka prezantuar diplomën e gjeodetit dhe e njejta është e ngarkuar në sistem tek Stafit profesional i inxhinjerëve;

Pretendimi juaj i II-të se: Grupit të Operatorëve Ekonomik “Marisa” sh.p.k. & “Company Murseli” sh.p.k., ju mungojnë kontratat e stafit teknik, nuk qëndron, sepse të njëjtat me dt.24.07.2020, i janë kërkuar me nenin 72, të LPP-së. Grupi i Operatorëve Ekonomik “Marisa” sh.p.k. & “Company Murseli” sh.p.k., me dt.25.07.2020, i ka ngarkuar në sistem (shih te funksioni “Dokumentat tjera”).

Pretendimi juaj i III-të se: Njëri nga anëtarët e konzorciumit kishte certifikatën e vjetëruar të biznesit, për ne ka qenë apo më mirë të themi e kemi konsideruar devijim të vogël.

Pretendimi juaj i IV-të se: Informatat e dhëna nga ne nuk kanë qenë në tërësi por të pjesëshme nuk qëndron, sepse me të gjithë Operatorët ekonomik ne jemi shumë transparent sa i përket qasjes në dokumente. Ato dokumente të cilat i kërkojnë Operatorët ekonomik ato edhe ju ofrojmë, nëse në këtë rast diqka nga dokumentet ka qenë e mangët, do të thotë se ju nuk e keni kërkuar.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivitet të Komunës

z.Faton Gataj  
  
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

